



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

DATA	17.08.2022
PËR/ZA/TO:	Z.Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës së Glllogocit
CC:	Znj.Venera Çerkini,zv.Sekretare e Përgjithshme/MAPL Z.Besim Myrtezani,zv.Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL Znj.Leonita Shabani,zv.Sekretare e Përgjithshme/ME Z.Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave/MAPL Z.Kujtim Aliu,Zyrtar i lartë Ligjor/MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z.Adem Ahmetaj, zv.Udhëheqës i NJPMNP-së.
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani,analiste/NJPMNP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Glllogocit

I nderuar,

Në pajtim me Rregullore (qrk) nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (qrk) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve publike/NJPMNP/Ministria e Ekonomisë/ME, ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:
Vendimin nr.prot.02-020/-400/01-24077 i Kuvendit të Komunës të Glllogocit i miratuar me datë 30.05.2022, i pranuar në NJPMNP/ME dt.16.08.2022, për fillimin e procedurës për themelimin e ndërmarrjes publike lokale , i miratuar nga Kuvendi dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në legjislacionin aktual për ndërmarrje publike respektivisht, Rregullorja nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, dhe Rregullore (QRK) nr. 19/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit, neni 4 paragrafi 1 " Komunitat kanë të drejtën për të krijuar ndërmarrje publike lokale sipas Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike", me plotësimin e kriterëve për krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale.

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është nismë për themelimin e NPL, por që të mund të prodhojë efekte juridike, KK Glllogoc duhet të veproj dhe të përmbushë kriteret e Rregullores nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin ndërmarrjeve publike lokale respektivisht plotësim ndryshimet e saj dhe të parashtroj kërkesë në NJPMNP/ME për themelimin të Ndërmarrjes në fjalë.

Sipas ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 11.1“ Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çdo ndërmarrje e re publike mund të themelohet vetëm nëse kjo autorizohet me një vendim të Qeverisë” dhe ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, neni 6 që plotëson Nenin 11 të ligjit bazik, me paragrafin 11.3 “Komunat kanë të drejtën për të krijuar ndërmarrje publike lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akt nën-ligjor të Qeverisë. Kriteret duhet të përshijnë kërkesa të arsyeshme për qëndrueshmëri operationale dhe financiare.

Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!



Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës



Nr. 02/400/01-24077 dt. 30.05. 2022

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.031/L-040, dhe Ligjit nr.04/L-111, Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike, dhe Rregulloren nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonal të ujit, neni 4,5 dhe 6 dhe Rregullores (QRK) Nr. 19/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr.02/2013 mbi kriteret e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit: Në bazë nenit 34, pika 34.6, e Statutit të Komunës së Glllogocit, i dt. 16.09.2008, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Glllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 05. 2022, miraton këtë:

V E N D I M

**Për nisjen e proceduarve për themelimin e ndërmarrjes publike lokale,
(NPL) në Drenas**

Neni 1

Me këtë Vendim Kërkojmë nga Kuvendi Komunal në Drenas, që të merr vendim për nisjen e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale në komunën e Drenasit duke u bazuar në ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës
Miladin Hajdari

ARSYETIM

Qëllimi i themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale (NPL) në Drenas është që të menaxhohen dhe mirëmbahen hapësirat publike në komunën e Drenasit.

Duke pasur parasysh se komuna e Drenasit është ndër komunat e Republikës së Kosovës që vitet e fundit është duke bërë hapa të dallueshëm dhe përparimtar në kompletimin e infrastrukturës publike me rrugë të reja, ujësjellës dhe kanalizim, rregullimin e hapësirave publike, gjelbërimin e hapësirave publike të qytetit të cilat kërkojnë edhe mirëmbajtje dhe ruajtje të këtyre investimeve në dobi të qytetarëve.

Komuna e Drenasit po bënë përpjekje që me kapacitete dhe mundësit buxhetore të ofroj shërbime të mira për qytetarët, andaj për të ofruar shërbim dhe mirëmbajtje të hapësirave publike kërkojmë që propozim vendimi të aprovohet nga kuvendi komunal në Drenas.

Komuna vetëm për mirëmbajtjen e hapësirave publike kontraktin operator ekonomik për këto shërbime:

Mirëmbajtjen e Sheshit dhe Hapësirave publike në komunën e Drenasit;

Larjen dhe Fshirjen e rrugëve gjatë sezonës së Verës; ,

Mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonës së Dimrit;

Largim të deponive ilegale

Mirëmbajtje e deponive të mbeturinave inerte

Këto projekte duke përfshirë edhe menaxhimin e mbeturinave është e domosdoshme që të kenë mirëmbajtje dhe përkujdesje institucionale nga komuna e Drenasit përmes themelimit të ndërmarrjes publike lokale (NPL). Me themelimin e ndërmarrjes publike lokale synojmë që këto shërbime të jenë të menaxhuara në mënyrën më të mirë të mundshme nga komuna e Drenasit.

Andaj kërkojmë nga asambleja që të aprovohet propozim vendimi për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale, për menaxhimin e hapësirave publike në Drenas.